



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 4 Prot.

Vlorë më, 22.01 2018

V E N D I M

Nr. 1, datë 22.01. 2018

"PËR MIRATIM FONDI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE AKTIVITETET NË
KOLEGJIN UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

Bazuar në nenet 47 dhe 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 29 të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit; si dhe në nenet 12 dhe 16 të Rregullores së funksionimit të IAL;

Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" (në vijim KUPV);

V E N D O S I:

1. Të miratoj fond për kërkimin shkencor dhe aktivitetet, në Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë".
2. Zyra e Financës të mbulojë shpenzimet për botime, konferenca shkencore dhe aktivitete të stafit dhe të studentëve, brenda dhe jashtë vendit, ku të përfshihen:
 - a. Zhvillimi i konferencave shkencore;
 - b. Zhvillimi i ekskursioneve, workshope, vizita studimore, etj;
 - c. Botime periodike të revistës shkencore "Pavarësia";
 - d. Botime të librave me autorë ose bashkëautorë nga stafi akademik;
 - e. Promovime të botimeve;
 - f. Blerje literature për bibliotekën e KUPV (libra dhe revista, në shqip dhe në gjuhë të huaj);
 - g. Udhëtime;
 - h. Pedagogët që publikojnë artikuj shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rimbursohen.
3. Për çdo aktivitet të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, Administratori i Kolegjit të marr masa për nxjerrjen e urdhrave, për lëvrimin e fondeve dhe mbulimin e shpenzimeve, sipas nevojave të institucionit.

4. Me këtë vendim të njihet gjithë stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ i Kolegjit.
5. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Administratori i Kolegjit dhe zyra e Financës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Z. Siri HOXHA

ANËTARË:

Z. Ardian ZYKAJ

Z. Gëzim LLOJDIA

Z. Ardian LIÇAJ

Z. Gëzim LIÇAJ